



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:283971

Datë: 01.03.2024

Numri i dokumentit: 05400621

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr./..

GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, me gjyqtarin e vetëm gjykues Mus Povataj, me pjesëmarrjen të bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të pandehurit Sh.T.. për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nen par 1.4 te KPRK-së, i akuzuar nga Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Përgjithshme sipas aktakuzës PP/II nr.2329/2023 të datës 13.12.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 21.02.2024 në prezencë të Prokurores se Shtetit Ardiana Veseli të pandehurit Sh.T., i dëmtuari Sh.T., dhe përfaqësuesi nga zyra për mbrojtjen e viktimave Luan Mehmeti , të njëjtën ditë bie dhe shpall publikisht, ndërsa me datë 01.03.2024 përpilon këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri,

SH.T.., i lindur me datën, me vendbanim në fshatin R... K-P., ku edhe banon aktualisht, lagja D., nga i ati S.. dhe e ëma M., i martuar babai 4 fëmijëve, i gjendjes se ulet ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër personal i nacionalitetit Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i dënuar me parë, mbohet ne liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me dt. 18.11.2023, rreth orës 20:40, në fsh. R.. K. P., pikërisht në shtëpinë e tij, brenda marrëdhënies familjare, me dashje i shkakton lëndime të lehta trupore të dëmtuarit Sh. T.. të cilin e ka vëlla, në atë mënyrë që, natën kritike, i dëmtuari gjersa ishte në gjendje të dehur shkon tek shtëpia e të pandehurit duke e thirrur dhe duke iu drejtuar të pandehurit me fjalët “Jysko ti ka kërkuar paret që ia ke borxh”, ku ia pandehuri i drejtohet me fjalët “shko ma andej dhe pritem” duke shkuar pas tij dhe me grusht e godet në anën e djathtë të buzës së poshtme, me ç’rast të dëmtuarit i ka shkaktuar lëndime trupore,

-Me çka ka kryer veprë penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nënpar.1.4 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve: 7, 17, 21, 38, 47, 49, 69,70 dhe 185 par.1 nen par 1.4 të KPRK-së, si dhe nenit 242 dhe 364, të KPPRK-së, të pandehurit Sh.T.. i shqipton:

GJYKON

Dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muaj, të cilin dënim i pandehuri nuk do të ta mbaj në rast se i njëjti në afat prej 1 (një) vite nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Dënimi me kusht do të mbikëqyret nga shërbimi sprovues. **URDHËROHET** i pandehuri Sh.T.. urdhërohet që të mbaj kontaktin me shërbimin sprovues në Pejë dhe i njëjti njoftohet nëse i shkëput kontaktet me shërbimin sprovues, gjykata mund të revokoj dënimin me kusht.

I pandehuri lirohet nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale.

I dëmtuara Sh.T.. nga fshati R.. K.. P., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Përgjithshme me datën 13.12.2023 ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.2329/2023 ndaj të akuzuarit Sh.T.. për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nen par 1.4 te KPRK-së.

Ne shqyrtimin fillestar të datës 21.02.2024 gjykata në pajtim me nenin 241 par. 1 të KPPRK-se e ka udhëzuar te pandehurin për të drejtën e tij për të mos u deklaruar në çështjen e tij ose të mos përgjigjet në pyetje dhe nëse ai deklaroi për çështjen, se nuk ka për detyrë të inkriminojë vetveten ose të afërmin, as të pranojë fajësinë, të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës juridike nga mbrojtësi sipas zgjedhjes së tij, të kundërshtojë aktakuzën dhe pranueshmërinë e provave të paraqitura në aktakuzë.

Pasi i pandehuri ka hequr dorë nga e drejta e leximit të aktakuzës gjykata është bindur se i pandehuri i ka kuptuar aktakuzat dhe nuk kanë nevojë për sqarime shtesë. Me pas gjykata e ka njoftuar te pandehurin për pasojat dhe benefitet e pranimit te fajësisë.

I pandehuri është deklaruar e pranoj fajësinë për veprë penale sipas aktakuzës, jam penduar dhe shton se është e vërtetë që e kam kryer këtë veprë, i kërkoj falje te dëmtuarit.

Në vlerësimin e pranimit te fajësisë nga ana e te pandehurit gjykata ka kërkuar mendimin nga ana e Prokurorit te Shtetit e cila ka deklaruar se: pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit, i njëjti pranim është bere ne mënyrë vullnetare nga i pandehuri dhe po ashtu gjen mbështetje ne shkresat e lëndës.

Në vlerësimin e pranimin të fajësisë nga ana e të pandehurit gjykata ka kërkuar mendimin nga ana e mbrojtësja e viktimave lidhur i cili ka deklaruar: pajtohem me pranimin fajësisë nga ana e te pandehurit.

I dëmtuari Sh.T.. ka deklaruar; pajtohem me pranimin fajësisë nga ana e te pandehurit, nuk kërkoj kompensim demi, të pandehurin e kam vëlla.

Gjyqtari i vetëm gjykues është bindur se ne seancën e shqyrtimit kryesor nuk ekzistojnë rrethana për hedhjen e aktakuzës nga neni 244 i KPPRK-së, si dhe janë vërtetuar faktet nga neni 242 par. 6 të KPPRK-se, ndërsa aktakuza mbështet ne këto prova siç janë: raporti policor i përpiluar nga zyrtari policor Granit Kasapi, me dt. 18.11.2023; raporti informues i dërguar me email nga zyrtari policor A.. K.. më datë 19.11.2023; deklarata e të pandehurit Sh.. T.., e dhënë në polici më dt.18.11.2023; deklarata e të dëmtuarit Sh.. T.., e dhënë në polici më dt. 18.11.2023; vërtetimi i matjes së sasisë së konsumimit të alkoolit për të dëmtuarin prej 1.2 mg/L; raporti mjekësor lidhur me lëndimet e të dëmtuarit, me numër protokollit 27534, i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Pejë- Emergjencia me datë 18.11.2023; akt ekspertimi mjeko- ligjor dt. 12.12.2023, i kryer nga Dr. F.. B., si dhe të bëhet shikimi ne shkresa tjera të lëndës, andaj ka marr aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri duke vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Andaj me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit i cili mbështet në provat në baze të së cilave bazohet aktakuza është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv te aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale nga neni 185 par.1 nen par 1.4 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 par.1, 2 dhe 3 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurën, gjykata mori pranimin e fajësisë, keqe ardhjen e shfaqur nga ana e të pandehurit, provokimin nga ana e të dëmtuarit i cili i ka shkuar në gjendje të dehur shkon tek shtëpia e të pandehurit, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata ka gjetur shkallën e faktin se vepra penale është kryer brenda marrëdhënies familjare si dhe i pandehur me parë ka qenë i dënuar me aktgjykimin e kësaj Gjykate P.nr.744/20 të datë 29.11.2023 për veprën penale të llojit të njëjte .

Gjyqtari i vetëm gjykues ka vlerësuar se me dënimin e shqiptuar si ne dispozitiv te këtij *aktgjykimi, duke i tërhequr e* vërejtjen me kërcënimin e dënimit mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin që i pandehuri Sh.T.. të lirohet nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale është marrë konform nenit 452 par. 4 të KPRK-së për faktin se i pandehuri është i gjendjes së dobët ekonomike është përfitues i ndihmës sociale në bazë të kartonit me numër 34589 lëshuar nga QPS-Pejë deri me datë 30.10.2024, jeton në bashkësi familjare prej 6 anëtarëve nga me çka ne rastin konkret do të rrezikohej gjendja materialë e të pandehurit.

Komfor nenit 462 par. 2 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarin e udhëzoi në kontest civil.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa komfor nenit 369 të KPPRK-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL
2023:283971, 01.03.2024**

Bashkëpunëtorja profesionale

Edona Berisha Kastrati

G j y q t a r i

Musë POVATAJ

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykatë.